



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA KRUJË

Nr _____ Prot.

Krujë, më ____ . ____ . 2023

**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
2024-2026
BASHKIA KRUJË**

SHTATOR, 2023

1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë

Burimi i informacionit: PPV/PZhS

Bashkia Krujë në kontekstin strategjik mbështet krijimin e një poli logjistik të integruar. Në përputhje me këtë vizion strategjik, në territorin e Krujës fokusi do të përqendrohet në zhvillimin e tri aseteve kryesore.:

1. Ekzistenca e një potenciali të rëndësishëm, të lidhur me kushtet intermodale të transportit dhe logjistikës, në përputhje me drejtimet strategjike të Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe projektet e planifikuara (Infrastrukturë dhe logjistikë);
2. Resursi i rëndësishëm kulturor, i përfaqësuar nga Kruja dhe malet e saj, por edhe nga burime të tjera të rëndësishme ekzistuese, për realizimin e turizmit antropogjen historik (Turizëm Kulturor);
3. Prania e sythave inovative që mund të krijojnë një program të zhvillimit të sektorit prodhues (Inovacion prodhimi) në një periudhë afatmesme. Në mënyrë të veçantë, për territorin e Krujës (veçanërisht në Fushë-Krujë) specializimi është i lidhur me logjistikën (në përputhje dhe me udhëzimet e planifikimit kombëtar), që lidhet edhe me ekzistencën e modaliteteve më të rëndësishme të transportit (aeroport, autostradë).

Në këtë kuptim, mund të konsiderohen si strategji të mirëfillta themelore:

- Politikat që synojnë zgjidhjen e nyjeve strukturore të komunitetit lokal (përcaktimi i aseteve të pronësisë, rregullat për taksimin lokal, normat për qeverisjen e miratuar të transformimeve);
- Programet që synojnë të garantojnë kushtet minimale të funksionimit teknik të vendbanimeve urbane (efiçenca e rrjeteve, efikasiteti i mënyrave të menaxhimit, aksesit ndaj resurseve);
- Ndërhyrjet që kanë për synim garantimin e qëndrueshmërisë së zonave të banuara (vënia në siguri e territorit, mbrojtja e trupave ujore, mbrojtja e resurseve mjedisore);
- Projektet që synojnë sigurimin e një sistemi urban të jetueshëm (organizimi i sistemit të transportit, krijimi i qendrave urbane, pajisja me shërbime publike të përmirësuara).

Plani i Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Krujë ka përcaktuar çështjet dhe drejtimet kryesore të zhvillimit të synuar për vitet e ardhshme të Bashkisë Krujë :

- ✚ Te zhvillojë dhe te zgjerojë rrjetin e rrugëve automobilistike, të integruar me sistemin e parkimeve urbane dhe territoriale,
- ✚ Te përmirësojë shërbimet bazë sociale dhe administrative;

- ✚ Shtimi i fondit të ndërtimit për shkak të rritjes së popullsisë, përmirësimit të kushteve të banimit, zëvendësimit të ndërtesave të degraduara nga koha
- ✚ Zhvillimi i qëndrueshëm i territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore
- ✚ Rikuperimi dhe rivitalizimi i qendrave urbane apo monumenteve historike,
- ✚ Forcimi i strukturave hoteliere dhe shërbimeve plotësuese të turizmit kulturor, mjedisor, sportiv në zonat urbane të Krujës si dhe në zonat me interes natyror peizazhistik si dhe në fshatrat e zonave të thella malore;
- ✚ Zhvillimi i qendrave të reja urbane në qendër të Fushë-Krujës dhe lokalitetet e tjera të mëdha urbane ;
- ✚ Rregullimi, sipas standardeve të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar, i strukturave infrastrukturore sekondare (objektet publike, gjelbërim dhe parkime), në zonat kryesore urbane.
- ✚ Zhvendosje e popullsisë prej zonave të rrezikshme apo të degraduara si dhe adresimi i nevojave për banesa sociale etj.
- ✚ Nxitja e qasjes, përdorimit dhe shkëmbimit të resurseve urbane të përbashkëta (Urban Commons) për të gjithë qytetarët, me vëmendje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara.
- ✚ Promovimi dhe zhvillimi i prodhimit cilësor në sektorin bujqësor, blegtoral dhe pyjor.

1. Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2024-2026 bazohet në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“, të ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 date 27.4.2017 “ Per financat e vetëqeverisjes vendore “ , Udhezimit Nr.7 datë 25.02.2022 “Per nje ndryshim në udhëzimin nr 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te njesive te vetëqeverisjes vendore,udhezimit nr. 6 date 28.02.2023 të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë “ Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2024-2026”dhe shtojca plotesuese nr 21 date 07.07.2023“ Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2024-2026”

Këshilli Bashkiak ka miratuar kalendarin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetin vjetor 2023 të Bashkisë Krujë me VKB nr 93 date 28.12.2022 dhe u confirmua nga Prefekti I Qarkut Durrës me shkresen nr 190/2 date 07.03.2022. Në zbatim të këtij vendimi, kryetari i bashkisë, në rolin e nëpunësit autorizues ka përcaktuar veprimtarinë e punës

të Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP) me qëllim përgatitjen e Programit Buxhetor 2024-2026 sipas hapave të mëposhtëm:

- Vlerësimi dhe parashikimi i të ardhurave për vitet 2024-2026 dhe dërgimi për miratim në Këshill Bashkiak.
- Vlerësimi i strukturës së programeve lidhur me planifikimin buxhetor për periudhën 2024-2026, duke siguruar perfshirjen brenda një programi shpenzimet sipas funksioneve të bashkisë.
 - Analiza e politikave dhe objektivave të programeve sipas funksioneve të veta, të deleguara dhe atyre të financuara me transfertëspecifike duke marrë në konsideratë të dhenat financiare të një viti më parë, vitit aktual dhe parashikimin dhe planifikimin për tre vitet e ardhshme.
 - Lidhja e objektivave strategjike të percaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor me objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm.
 - Prioriteteve të investimeve të miratuara në PPV dhe të konsultuara me qytetarët dhe grupet e interesit, në fushën e infrastrukturës publike.
 - Analizës së shpenzimeve operative (dy vite më parë, viti aktual dhe për tre vitet e ardhshme).
 - Analizës së parashikimit të shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2024-2026, sipas çdo programi (për tre vitet e ardhshme).
 - Analizës së vlerësimit të projekteve dhe lidhjen e tyre me programet e shpenzimeve publike.
 - Analizës së shërbimeve të mirembajtjes së objekteve arsimore, administrative, rrugëve të brendshme dhe atyre rurale.
 - Shpërndarjen tek çdo Ekip i Menaxhimit të Programit të udhëzimeve të brendshme të nënshkruara nga titullari në lidhje me zbatimin e procedurave të programit buxhetor afatmesëm.
 - Diskutimin me drejtuesit e programeve për dokumentin e risqeve të paraqitur prej tyre dhe përcaktimin e risqeve prioritare për t'u diskutuar në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
 - Nënshkrimin e të gjithë raporteve të përgatitjes së kërkesave buxhetore për përdorim të brendshëm të njesisë në lidhje me Rishikimin e Politikës së Programit dhe Planifikimin e Shpenzimeve të Programit.
 - Prezantimin tek Kryetari i Grupit të Menaxhimit Strategjik të të gjithë dokumentacionit të kërkesave buxhetore.

Drejtoria e Te ardhurave ka paraqitur raportin e vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Krujë për vitet 2024-2026 ". Bashkia Krujë me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 16 datë 28.03.2023 " Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 të Bashkisë Krujë", ka miratuar tavanet përgatitore të PBA 2024-2026 dhe në bazë të këtyre taveve janë hartuar kërkesat buxhetore nga ekipet e menaxhimit të programeve.

2. Buxheti Afatmesëm 2024-2026 i Bashkisë Krujë

Buxheti total i Bashkisë Krujë për vitin 2024 është planifikuar 1,377,556, për vitin 2025 është parashikuar në 1,406,924 mijë lekë dhe për vitin 2026 është parashikuar 1,436,382 mijë lekë .

Financimi i buxhetit realizohet nga :

- Burimet e veta vendore,ku perfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara,te ardhurat nga te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura te tjera dhe te ardhura qe trashegohen.
- Nga grantet e projekteve të huaja dhe donacionet, ku përfshihen grantet e përfituara përmes thirrjeve për propozime, për zbatimin e projekteve të financuara nga programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar etj, në përputhje me ligjet për ratifikimin e marrëveshjeve të financimit dhe VKM-ve për miratim në parim të marrëveshjeve të financimit.
- Nga burimet qendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë, transferta specifike dhe transferta e kushtëzuar

Tabela 1: Të ardhurat e Bashkisë Krujë sipas Burimit

(000/lekë)

Nr	Burimet e Financimit te Bashkise Kruje	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
I.	Nga Burimet e veta Vendore	357'000	364'141	370'000
1.	Të ardhura nga taksat lokale	170'032	173'433	176'220
2.	Të ardhura nga taksat e ndara	89'760	91'555	93'030
3.	Të ardhura nga tarifat vendore	96'727	98'662	100'251
4.	Të ardhura të tjera	481	491	499
II.	Nga Burimet Qendrore	1'020'556	1'042'783	1'066'382
1.	Transferta e pakushteuar	366'966	387'137	408'659
2.	Transferta e pakushteuar sektoriale	205'590	207'646	209'723
3.	Transferta e kushteuar	448'000	448'000	448'000
	TOTALI	1'377'556	1'406'924	1'436'382

3. Të ardhurat dhe shpenzimet publike të Bashkisë Krujë në vitet 2024-2026

Disa tregues të rëndësishëm për buxhetin:

- Të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore për vitet 2024-2026, zënë mesatarisht 26% të totalit të buxhetit

- Transferta e pakushtëzuar për vitet 2024-2026 zë mesatarisht 27% të totalit të buxhetit.
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitet 2024-2026 zë mesatarisht 15% të totalit të buxhetit.
- Transferta e kushtëzuar për vitet 2024-2026 zë mesatarisht 32% të totalit të buxhetit.
- Totali i shpenzimeve të planifikuara të personelit për vitin 2024 është 420'676 mijë lekë dhe zë 31 % të totalit të shpenzimeve, për vitin 2025 është parashikuar 421'911 mijë lekë dhe zë 30% të shpenzimeve dhe për vitin 2026 është planifikuar 430'348 mijë lekë dhe zë 30% të totalit të shpenzimeve.
- Totali i shpenzimeve operative për vitin 2024 është 855,139 mijë lekë dhe zë 58% të totalit të shpenzimeve, për vitin 2025 është parashikuar 863'954 mijë lekë dhe zë 58 % të totalit të shpenzimeve dhe për vitin 2026 është parashikuar 882,554 mijë lekë dhe zë 58% të totalit të shpenzimeve.
- Totali i shpenzimeve kapitale për vitin 2024 është 98'445 mijë lekë dhe zë 7 % të totalit të shpenzimeve, për vitin 2025 është parashikuar 121'059 mijë lekë dhe zë 9% të shpenzimeve, për vitin 2026 është planifikuar 123'480 mijë lekë dhe zë 9% të totalit të shpenzimeve.

3.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Krujë për vitet 2024-2026

Të ardhurat nga burimet qendrore rezultojnë të jenë dominuese dhe përcaktuese në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale duke bërë të mundur që planifikimi I investimeve kapitale të kushtëzohet nga transfertat dhe vendimet e qeverisë qendrore. Pavarësia financiare e Bashkisë Krujë ,matur si raport I të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave totale, parashikohet të jetë mesatarisht në nivelin 26 % për trevjecarin 2024-2026.

Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit është e ardhur për njësitë e qeverisjes vendore, e përfituar në formën e dhurimit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet të njësive të qeverisjes vendore, të përcaktuara ne Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe te ligjit 68/2017 ,”Per financat e qeverisjes vendore”neni 24.

Persa i perket nivelit të transfertës së kushtëzuar dhe të pakushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, ajo përcaktohet çdo vit në ligjin e buxhetit të shtetit.

Transferta e pakushtëzuar sipas udhëzimit te Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.06 dt 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”. Për vitin 2024 ka vleren 366'966 mijë lekë; për vitin 2025 në vlerën 387'137 mijë lekë dhe për vitin 2026 në vlerën 408'659 mijë lekë.

Transferta e kushtëzuar, ku përfshihen fondet për ndihmat ekonomike, PAK, strehimin social gjendjen civile, rindërtimin nga dëmtimet e termetit akordohen nga pushteti qendror.

Ndërsa përsa i përket transfertës specifike për vitet 2024-2026, Bashkisë Krujë parashikohet ti akordohen fonde për funksionet e arsimit parauniversitar dhe parashkollor, administrimin e pyjeve, ujitja dhe kullimi, mbrojtja nga zjarri dhe rruget rurale për vitin 2024 në vlerën 205'590 mijë lekë , në vitin 2025 në vlerën prej 207'646 mijë lekë dhe për vitin 2026 një vlerë prej 209'723 lekë.

Në këtë transfertë përfshihen: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit, shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime për secilin funksion të lartpërmendur.

Parashikimi i te ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore sipas planit të te ardhurave për tre vitet e ardhshme nga Drejtoria e Tatimit Taksave paraqiten: për vitin 2024- 357,000 mijë lekë , për vitin 2025 – 364'141 mijë lekë ,për vitin 2026 në vlerën prej 364,141 mijë lekë. Niveli I të ardhurave vendore përcaktohet në masën më të madhe nga performanca e taksave dhe tarifave vendore. Nga analiza e planifikimit të te ardhurave nga Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vendore , vihet re një parashikim me rritje në taksën e tokës bujqesore në krahasim me vitet e mëparshme si rezultat i shpërndarjes së akt-detyrimeve për pronarët e tokave. Gjithashtu me rritje parashikohen edhe të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë si rezultat i shtimit të ndërtimeve të reja dhe rritja e shkallës së mbledhjes së tyre nëpërmjet metodave ligjore. Taksa e tabelës parashikohet gjithashtu me të ardhura të rritura si rezultat i sensibilizimit të biznesit dhe fuqizimit të tyre ekonomik.

Sic vihet re, Parashikimi i buxhetit afatmesëm për Bashkinë Krujë për tre vitet e ardhshme ka në qendër të saj rritjen e të ardhurave, rritjen e shërbimeve dhe të cilësisë së jetës së qytetarëve . Vizioni ynë është që të krijojmë një sistem që nxit transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efektivitetin në mbledhjen dhe administrimin e burimeve financiare. Kjo do të krijojë mundësi për shërbime më të mira dhe zhvillim të mëtejshëm ekonomik.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhura nga taksat e ndara, nga tarifave vendore, dhe të ardhurat e tjera. Llogaritja e të ardhurave mbështetet në:

1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“ të ndryshuar;
3. Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Planifikimi i te ardhurave nga taksat/tarifave është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Krujë, të përditësuar, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për

vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj. Në përditësimin e paketës fiskale të Bashkisë së Krujës ndër vite, janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh dhe të vogël, banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe përfaqësues të partive politike e këshilltarë. Diskutimet publike janë organizuar në çdo njësi administrative dhe në qytet. Për ndryshimet dhe përditësimet e paketës fiskale janë bërë takime konsultative gjithëpërfshirëse. Gjatë këtyre takimeve bashkëqytetarë, banorë, përfaqësues të grupeve të interesit, është diskutuar dhe janë bërë propozime për përmirësim. Paketa fiskale e Bashkisë së Krujës, pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

Politikat incentivuese në taksa:

- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi në Nj.A. në 30% nga referenca ligjore.
- Taksë banese zero për pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike.
- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime biznesi në Nj.A. në 30% nga referenca ligjore.
- Ulje në nivelin maksimal të lejuar prej 30% të taksës së tokës bujqësore.
- Ulje deri në nivelin minimal ligjor për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të tarifave sipas llojit. Bashkia e Krujës ka kërkuar lidhjen e të dhënave për pasuritë e paluajtshme që disponon ASHK (Agjensia Shtetërore e Kadastrës) me sistemin e Kadastrës Fiskale që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e llogaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimin e tyre brenda kufijve e sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Parashikimi i të ardhurave vendore për Bashkinë e Krujës në tre vitet e ardhshme është i mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapaciteteve të taksave e tarifave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në vite, si dhe politikat e përcaktuara për vitet pasardhëse, duke u mbështetur në legjislacionin aktual në fuqi. Sipas këtij parashikimi synohet një rritje e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, duke forcuar kapacitetet administruese duke bërë të mundur rritjen e numrit të taksapaguesve nepermjet politikave që luftojnë evazionin fiskal dhe ekonominë informale. Faktorët e rritjes së të ardhurave gjatë viteve 2024-2026 janë përmirësimi i performancës së punës në mbledhjen e të ardhurave, ndryshimi i normës së taksave, lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet dhe familjarët si dhe masat e marra kundër evazionit fiskal.

3.2 Plani i shpenzimeve te Bashkise Krujë për periudhën 2024-2026

Totali i shpenzimeve të personelit për vitin 2024 është 420'676 mijë lekë dhe zë 31 % të totalit të shpenzimeve, për vitin 2025 është parashikuar 421'911 mijë lekë dhe zë 30% të shpenzimeve dhe për vitin 2026 është planifikuar 430'348 mijë lekë dhe zë 30% të totalit të shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve operative për vitin 2024 është 855,139 mijë lekë dhe zë 58% të totalit të shpenzimeve,për vitin 2025 është parashikuar 863,954 mijë lekë dhe zë 58 % të totalit të shpenzimeve dhe për vitin 2026 është parashikuar 882,554 mijë lekë dhe zë 58% të totalit të shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve kapitale për vitin 2024 është 98'445 mijë lekë dhe zë 7 % të totalit të shpenzimeve,për vitin 2025 është parashikuar 121'059 mijë lekë dhe zë 9% të shpenzimeve,për vitin 2026 është planifikuar 123'480 mijë lekë dhe zë 9% të totalit të shpenzimeve.

Planifikimi i buxhetit për vitet 2024-2026 sipas klasifikimit ekonomik

(000/lekë)

Zerat e Shpenzimeve	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
Paga dhe Sigurime shoqerore	420'676	421'911	430'348
Shpenzime operative	855,139	863,954	882,554
Investime	98'445	121'059	123'480
TOTALI	1'377,556	1'406'924	1'436'382

Planifikimi i buxhetit për vitet 2024-2026 sipas programeve

(000/lekë)

Programi	Emertimi	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
1110	Planifikimi,menaxhimi, administrimi	135'802	137'889	140'647
3140	Sherbimet e Policise Vendore	17'579	17'631	17'984
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	45'413	45'472	46'483
4130	Mbeshtetje per zhvillimin ekonomik	13'095	13,094	13,356
4220	Sherbimet bujqesore,inspektimi,ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	18'078	18,134	18,497

4240	Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	17,276	17'352	17,699
4260	Administrimi I pyjeve dhe kullotave	7,609	7'631	7,784
4520	Rrjeti rrugor rural	74'251	95'212	97'116
5100	Menaxhimi I mbetjeve	112'206	111'756	115'011
6140	Planifikimi Urban Vendor	94'693	94'729	96'623
6260	Sherbimet Publike Vendore	138,988	142'861	145'718
6370	Furnizimi me uje dhe kanalizime	30'069	30'144	30,747
8130	Sport dhe Argetim	56'505	56,775	57'910
8220	Trashegimia kulturore,eventet artistike dhe kulturore	13'658	13,718	13,992
9120	Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor	132'054	132'486	135'136
9230	Arsimi I mesem I pergjithshem	19'426	19,464	19'853
10430	Kujdesi social per familjet dhe femijet	441'558	441'626	450'459
	Fond rezerve + kontigjence	9'296	9'589	9'884
	TOTALI	1'377'556	1'406'663	1'434'899

4. Detyrime të prapambetura

Bashkia Krujë ka detyrime të prapambetura në shumën 17'602'310 leke që janë procedura të prapambetura të viteve të kaluara. Gjatë vitit 2022 Bashkia Krujë ka shlyer më shumë se 50% të detyrimeve të prapambetura në një vlerë prej 19'306 mijë lekë. Detyrimet e prapambetura planifikohen të likujdohen plotësisht brenda një periudhe dyvjeçare duke përfshirë edhe vitin aktual 2023. Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura është 7'931'338 lekë për vitin 2023, dhe vlera e mbetur prej 9'670'972 planifikohet të likujdohet gjatë vitit 2024 duke mbajtur në vëmendje të vecante edhe moskrijimin e detyrimeve të reja kreditore.

Vlerësimi i rreziqeve financiare e fiskale krijon mundësi për marrjen e masave për zvogëlimin e riskut dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Disa nga risqet fiskale janë mungesa e likuiditetit nga Biznesi, ulja e remitançave, ulja e kreditimit nga Bankat e nivelit të dytë, mungesa e informacionit ndaj bizneseve për detyrimet që ka si dhe mospagesa e detyrimeve të prapambetura. Këto sjellin edhe mosrealizim të shpenzimeve dhe për efekt moszbatimi i buxhetit dhe lindjen e detyrimeve të prapambetura. Bashkia Krujë ka ndërmarrë

masa te ndyshme per uljen e riskut si:

-Krijimi i lehtësirave për biznesin, gjetja e mënyrave për subvencionimin dhe nxitjen e krijimit të bizneseve të reja.

-Evidentimi i të gjitha bizneseve që kanë detyrime të prapambetura, njoftimi i subjekteve për detyrimet, negociim për mënyrën e pagesës. Kontaktet sa më shpeshta dhe më intensive me subjektet që kanë detyrime te prapambetura..

-Njoftimi për vonesa, aplikimi i gjobave, bllokimi i aktivitetit, bllokimi i llogarive dhe të gjitha masat e tjera konform ligjit.

-Monitorimi i limiteve mujore të shpenzimeve dhe rakordimi i shpenzimeve mujore me të dhënat e Buxhetit.

5. Konkluzione

Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 përmban tavanet përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve duke mbajtur parasysh kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.6 dt 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”.Ky program buxhetor pasqyron parashikime te treguesve ekonomike dhe financiare te buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme duke ofruar vlerësime të burimeve që Bashkia Krujë do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.Në shpenzimet e planifikuara janë mbajtur parasysh shpërndarja e tyre sipas programeve buxhetore dhe peshën e secilit program sipas prioriteteve strategjike për investimet publike. Parashikimi për shpenzimet për personelin u bë në mbështetje të numrit të punonjësve të planifikuar me ligj.Në parashikimin për shpenzimet operative u mbështetëm në realizimin e shpenzimeve të viteve të kaluara dhe shpenzimet e domosdoshme për funksionimin e institucionit. Gjatë viteve 2022-2023 përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi plotësisht të ardhurat buxhetore të parashikuara, të nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve të larmishme që bashkia ka. Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, implementimit të procedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë. Objektivat janë planifikimi buxhetor, llogaritja, analizimi dhe kontabilizimi i burimeve financiare të të ardhurave të veta, ndjekja e politikave dhe strategjive sensibilizuese, mbështetese dhe zhvilluese për krijimin e të ardhurave, zbutjes së informalitetit, rritjes së konkurrencës së ndershme, si dhe administrimi i marëdhëniet me taksapaguesit dhe shërbimi ndaj tij. Objektivat kryesisht janë të orientuara në lehtësimin maksimal fiskal dhe shpërndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore, kane ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet

Zyrave me Një Ndalese dhe agentit tatimor Ujesjelles Kanalizime Kruje të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

KRYETARI I BASHKISE

ARTUR BUSHI

Zv/Kryetar
ILIR LOCI

SEKRETAR I PERGJITHSHEM
FLORIND CERHOZI

D/TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
LINDITA TAÇI

D/FINANCES
ESAT FARRUKU

D/KABINETIT
MEHMET DELIU

D/BURIMEVE NJEREZORE DHE PERSONELIT
HAMDI ZAJA

D/JURIDIKE
ANILA HAXHI

D/ PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
ERGYS SALLAKU

D/ BUJQESISE DHE MENAXHIMIT TE PRONAVE
ERISA DACI

D/ SHERBIME DHE INVESTIME PUBLIKE
EDI SALAJ

D/ SHERBIMI SOCIAL
ILIRA SUTA

D/ARSIM KULTURES DHE SPORTIT
ELIS HYSA